



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, më 25 shkurt 2016, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu- Kodra dhe Elmi Reçica.

Munguan: Enver Hoxhaj, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca e Zafir Berisha.

Në takim ishte i pranishëm, Shemsudin Mehmedović (Šemsudin Mehmedović), kryetar i Komisionit për Tregti të Jashtme dhe Doganë në Asamblenë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Maja Marinković –Ambasada e SHBA-ve dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Teuta Rugova, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Takim i Komisionit me z. Shemsudin Mehmedović, kryetar i Komisionit për Tregti të Jashtme dhe Doganë në Asamblenë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës

Teuta Rugova, fillimisht prezantoi anëtarët e Komisionit. Ajo falënderoi z. Mehmedović për vizitën dhe shpreson se tani e tutje do të kemi një bashkëpunim më të ngushtë në mes të dy parlamenteve.

Qerim Bajrami, falënderoi z. Mehmedović për këtë vizitë zyrtare dhe për hapin e guximshëm, të ndërmarrë, për t'i vënë kontaktet e para me Kosovën, gjegjësisht në mes të parlamenteve të dy shteteve. Z. Bajrami tha se ky hap është shumë i rëndësishëm, sepse qytetarët tanë kanë nevojë për kontakte të ndërsjella bashkëpunimi në mes vete. Kërkoj që Qeveria e Bosnjës e Hercegovinës, të heqë regjimin e vizave dhe të mundësohet lëvizja e lirë e qytetarëve në mes të dy vendeve.

Po ashtu, theksoi se edhe Qeveria jonë ka vënë regjimin e vizave me Bosnjë e Hercegovinën dhe kontaktet tona janë vështirësuar shumë.

Për t'u pajisur me viza, qytetarët tanë duhet të udhëtojnë në Shkup apo në Podgoricë, por edhe qytetarët e Bosnjës e Hercegovinës, për t'u pajisur me viza të Kosovës, duhet të udhëtojnë në Tiranë apo Zagreb, prandaj edhe kontaktet na janë zvogëluar. Ne boshnjakët kemi, posaçërisht, nevojë për kontakte, pasi që nuk ka boshnjak në Kosovë, që nuk ka të afërm në Bosnjë, e po ashtu ka një numër të madh të shqiptarëve, të cilët jetojnë në Bosnjë e Hercegovinë, ku edhe ata kanë nevojë për kontakte. Kërkoj që çështja e heqjes së regjimit të vizave, të ngrihet në mes të dy shteteve dhe të mundësohet lëvizja e lirë e qytetarëve tanë, përmes letërnjoftimit, theksoi z. Bajrami. Po ashtu, shpreson që në të ardhmen kontaktet në mes të parlamenteve të dy vendeve, do të avancohen.

Shemsudin Mehmedović, falënderoi për pritjen e ngrohtë që i është bërë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Mes tjerash, theksoi se dëshiron të jetë një urë lidhëse në mes të gjeneratës së vjetër dhe asaj të re, ndërsa këtë vizitë e konsideron simbolikë ndërlidhëse në mes të dy vendeve. Bëri të ditur se Bosnja e Hercegovina ka një mënyrë shumë komplekse të marrjes së vendimeve, për shkak të rregullimit kushtetues të komplikuar, por kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet bërë përpjekje që t'ju mundësojmë qytetarëve tanë lëvizjen e lirë. Ideja e propozuar për lëvizjen e lirë të qytetarëve tanë me letërnjoftime, është një ide e mirë dhe se këtë ide do t'ua prezantoj organeve, të cilat merren me këtë çështje në Bosnjë e Hercegovinë, theksoi z. Mehmedović.

Blerta Deliu-Kodra, i bashkëngjitet propozimit të z. Bajrami, që në mes të dy shteteve të mundësohet lëvizja e lirë e qytetarëve, përmes kartave të identitetit. Ky takim, do të përcjellë mesazhet tona të përbashkëta, se i kontribuon të dy shteteve dhe një të ardhmeje të përbashkët evropiane. Beson se Kosova dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të jenë të hapur edhe për takime të tjera në mes të dy vendeve, sepse ky takim shënon një pikënisje nga raportet që nuk i kemi pasur.

Elmi Reçica, tha se vizita e z. Mehmedović është shumë e mirëpritur, me peshë dhe e rëndësishme për ne. Populli shqiptar dhe ai boshnjak kanë pasur raporte të mira gjatë gjithë historisë dhe ekziston një bazë e shëndoshë për t'i avancuar raportet, në mes të dy vendeve. Z. Reçica, vizitën e z. Mehmedović e cilësoi si një hap shumë të guximshëm, që do të jetë pjesë e historisë, e domosdo, edhe pikënisje për avancimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve. Ne kemi nevojë të bëjmë njohjen e ndërsjellë, mundësinë e bashkëpunimit më të thellë, duke filluar nga lëvizja e lirë e qytetarëve, përmes dokumenteve të identifikimit, bashkëpunimit në fushën e ekonomisë, arsimit e kulturës. Diplomacia parlamentare, në shumë raste, iu ka paraprirë shumë proceseve, prandaj shpresojmë se kjo nismë do të jetë e rëndësishme për proceset tona të ndërtimit të shteteve, theksoi z. Reçica.

Shemsudin Mehmedović, theksoi se do të jetë urë lidhëse për vënien e kontakteve në mes të dy vendeve dhe për marrëveshjen e parë për lëvizjen e lirë për qytetarët tanë. Falënderoi z. Qerim Bajrami dhe Komisionin, për iniciativën e ndërmarrë në realizimin e kësaj vizite.

Teuta Rugova, në emër të Komisionit, falënderoi z. Shemsudin Mehmedović për vizitën në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke dëshiruar që edhe në të ardhmen të kemi vizita të tilla. Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetare e Komisionit,

Teuta Rugova